



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2019:293916

Datë: 16.11.2021

Numri i dokumentit: 02410948

**P.1415/19**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit F.R., duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit QN.nr.186/21, të datës 04.11.2021, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj, në mes të pandehurit F.R. në njërën anë dhe F.K. përfaqësuesit me autorizim i palës së dëmtuar KEDS, në anën tjetër, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2270-11/19, të datës 17.12.2019, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, në mbështetje të nenin 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, më datën 16.11.2021 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

APROVOHET marrëveshja QN.nr.186/21, të datës 04.11.2021, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurit F.R. në njërën anë dhe Ferat Krasniqit përfaqësues me autorizim i palës së dëmtuar KEDS-Distrikti Ferizaj, në anën tjetër.

Hudhet aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2270-11/19, të datës 17.12.2019, dhe PUSHON procedura penale kundër të pandehurit F.N.R., me vendbanim në Ferizaj rruga “...” kati i ... nr...., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

## **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.2270-11/19, të datës 17.12.2019, të pandehurin e ka akuzuar për veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Me dakordimin e palëve në shqyrtimin fillestar me dt.19.08.2021, konform nenit 4 dhe 8 të Ligjit për ndërmjetësim, u vendos që lënda të dërgohet në Qendrën për Ndërmjetësim.

Me datën 04.11.2021, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj, është arritur marrëveshja QN.nr.186/21, në mes palëve në procedurë.

Andaj Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenin 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim e aprovoj këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhë me vullnetin e plotë të palëve për çështjen dhe është në pajtim me ligjin për ndërmjetësim në fuqi.

Konform nenit 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim më datën 16.11.2021, aprovohet nga gjykata marrëveshja për ndërmjetësim dhe e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Konform nenit 454 par.1 të KPK-së shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 253 par. 1 pika 1.3 të KPPK lidhur me nenin 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL  
P.1415/19, me dt.16.11.2021.**

**Zyrtare ligjore  
Kimete Bytyqi**

**Gjyqtari  
Imri Sejda**

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 3/tre/ditëve nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.